

Informata për Lijën e majmunëve

- Sipas të dhënave të 23 maji, 11 vende në Rajonin e Evropës kanë raportuar raste të lisë së majmunëve të konfirmuar ose të mundshëm që nga fillimi i muajit maj 2022.
- Kjo nuk është ngjarje tipike. Është ngjarje e pazakontë sepse përveç njërit rast, të gjitha rastet tjera, nuk kanë histori përkatëse të udhëtimit në zonat ku lija e majmunëve është endemike. Hetimet e mëtejme janë duke u zhvilluar për të përcaktuar burimin, shtrirjen e mundshme të infeksionit dhe për të penguar përhapjen e mëtejme.
- Deri më tani, rastet janë gjetur në disa zona urbane dhe kryesisht të lidhura me kontaktin seksual. Rreziku për popullatën e përgjithshme mendohet të jetë relativisht i ulët.
- Mos harroni, lija e majmunëve nuk përhapet lehtë, kërkon kontakt të zgjatur personal dhe mund të prekë këdo. Ndërsa, disa raste janë raportuar tek njerëzit që kanë pasur kontakt të ngushtë dhe seksual, andaj virusi mund të prekë këdo.
- Teksa hyjmë në sezonin veror të manifestimeve, tubimeve masive dhe ahengjeve, rëndësi ka ajo që bëjnë njerëzit në festa. Ne inkurajojmë sjellje të sigurt seksuale dhe higjienën e mire: larja e rregullt e duarve për të ndihmuar kufizimin e transmetimit të virusit.
- OBSH-ja po punon me vendet e shqetësuara duke lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe përkrahur mbikëqyrjen, testimin, parandalimin e infeksionit, menaxhimin klinik, komunikimin e rrezikut dhe angazhimin e komunitetit.
- Simptomat mund të jenë të lehta ose të rënda dhe lezionet mund të shkaktojnë shumë kruarje ose dhimbje. Këto përfshijnë skuqje vezikulare të përhapura ose lezione në çdo pjesë të trupit. Shumica e rasteve të paraqitura kohët e fundit në klinikat e shëndetit seksual në Evropë janë paraqitur me skuqje dhe lezione në organet gjenitale dhe anusin e tyre.

Skuqja ose lezionet mund të shoqërohen me ethe, dhimbje të fytyrës, ënjtje të nyjeve limfatike dhe lezione të gojës dhe syve. Shumica e njerëzve shërohen brenda pak javësh pa trajtim.

- Është e rëndësishme që njerëzit të informohen rreth lisë së majmunëve dhe të mund të dallojnë shenjat dhe simptomat. Çdo person që është i shqetësuar për një skuqje të pazakontë duhet të konsultohet me mjekun ose ofruesin e kujdesit shëndetësor.

- Çdo pacient me dyshime për linë e majmunit duhet të hetohet dhe izolohet gjatë periudhave të supozuara dhe të njohura infektive përkatësisht gjatë fazës prodromale dhe të skuqjes së sëmundjes.

- Gjurmimi me kohë i kontakteve, masat e mbikëqyrjes dhe komunikimi i rrezikut ndërmjet ofruesve të kujdesit shëndetësor janë të domosdoshme për parandalimin e rasteve të reja dhe menaxhimin efektiv të epidemisë aktual.

- Qëndroni të informuar dhe përdorni burime të besueshme informacioni. Përditësimet e rregullta të OBSH-së për linë e majmunit mund të gjenden këtu: https://www.who.int/health-topics/monkeypox#tab=tab_1

Pyetje dhe përgjigje

1. A është komuniteti MSM përgjegjës për shpërthimin e lisë së majmunëve?

Komuniteti MSM nuk është përgjegjës për epideminë dhe është e gabuar të stigmatizosh dikë për shpërthimin. Kushdo mund t'a marrë atë dhe kushdo mund ta bartë atë.

Kjo është ajo që dimë. Virus i cili nuk përhapet lehtë, kërkon kontakt të zgjatur personal. Ndërsa, mund të prekë këdo, jo të gjithë janë në rrezik të barabartë. Njerëzit që kanë një

ndërveprim të ngushtë me dikë që është infeksioz janë në rrezik më të lartë për t'u infektuar: kjo përfshin punonjësit shëndetësorë, anëtarët e familjes dhe partnerët seksualë.

2. Çfarë dimë deri tani për virusin dhe si përhapet?

Lija e majmunëve është infeksion i rrallë viral, që përhapet nga personi në person dhe shkaktohet nga virusi me po të njejtin emër. Është endemike në disa vende të Afrikës qendrore dhe perëndimore.

Raste sporadike kanë ndodhur gjatë viteve të fundit në Evropë, zakonisht në vende me lidhje me Afrikën perëndimore dhe qendrore ku sëmundja qarkullon në një rezervuar kafshësh të paidentifikuar. Zakonisht shoqërohen me udhëtime ndërkombëtare. Rastet e importuara zakonisht nuk shpiejnë në përhapje të gjerë në komunitet – megjithëse është dokumentuar një transmetim i kufizuar në kontaktet e punonjësve shtëpiakë dhe shëndetësorë. ShBA, poashtu dokumentoi epideminë e vitit 2003 të lidhur me importimin e kafshëve ekzotike.

Rastet e fundit të lisë së majmunëve janë atipike, pasi ato po identifikohen ndër individë që nuk kanë histori të udhëtimit në vendet ku dihet se virusi qarkullon dhe nuk kanë asnjë lidhje të dukshme.

Deri me datë 23 maj, 11 shtete të Evropës kanë raportuar rreth 100 raste të lisë së majmunëve që nuk lidhen me historinë e udhëtimit përkatëse gjatë javës së kaluar (që nga 13 maji) – kjo përjashton vendet ku virusi është endemik.

OBSH po punon së bashku me shtetet dhe partnerët, për të kuptuar shkallën e përhapjes dhe për të ofruar këshilla të menjëhershme se si të parandalohet përhapja e mëtejshme e sëmundjes.

3. Në Evropë, klinikisht, sa të rënda janë rastet e lisë së majmunëve?

Aktualisht në Evropë, shumica e rasteve që po hetohen janë klinikisht të lehta. Lija e majmunëve është zakonisht sëmundje vetëkufizuese dhe shumica e të infektuarve do të shërohen brenda pak javësh pa trajtim.

Megjithatë, sëmundja mund të jetë më e rëndë, veçanërisht tek fëmijët e vegjël, gratë shtatzëna dhe individët me imunitet të kompromentuar.

Personat e infektuar me virusin e lies së majmuni janë infektues përderisa kanë simptoma (normalisht për dy deri në katër javë).

4. Si përhapet?

Normalisht, lija e majmunit nuk përhapet shumë lehtë midis njerëzve dhe kërkon kontakt të ngushtë duke hyrë në trup përmes lëkurës së dëmtuar, traktit respirator, syve, hundës ose gojës dhe përmes lëngjeve trupore. Poashtu, përhapet përmes kontaktit të zgjatur me gjësendet e tyre të kontaminuara (veshje, krevat, peshqirë, etj).

Transmetimi përmes spërklave të frymëmarrjes zakonisht kërkon kontakt të zgjatur ballë për ballë, gjë që i vë në rrezik më të madh punëtorët shëndetësorë, anëtarët e familjes dhe kontaktet tjera të afërta të rasteve aktive.

5. A janë të ngjajshme lija e majmunëve me COVID-19 dhe a duhet njerëzit të shqetësohen?

Këto janë dy sëmundje krejtësisht të ndryshme, përderisa pandemia COVID-19 ka shkaktuar vdekjen e mbi 2 milion personave në Evropë, rastet fillestare të raportuara nga lija e majmunëve janë kryesisht të lehta.

Është e rëndësishme të mbahet në mend, se virusi i lies së majmunëve nuk përhapet lehtë si SARS-CoV-2. Ai kërkon kontakt të zgjatur dhe të ngushtë personal me një person tjetër që është i infektuar ose duke rënë në kontakt me veshjet e

kontaminuara ose çarçafët e një personi të infektuar. Megjithatë, lija e majmunit mund të jetë sëmundje e rëndë veçanërisht tek fëmijët, gratë shtatzëna dhe njerëzit me imunitet të komprometuar.

6. Sa të shqetësuar duhet të jemi për një tjetër pandemi të mundshme?

Është e rëndësishme të kihet parasysh se virusi i lisë së majmunëve nuk përhapet lehtë si SARS-CoV-2. Ai kërkon kontakt të zgjatur dhe të ngushtë personal me një person tjetër që është i infektuar ose duke rënë në kontakt me veshjet e kontaminuara ose çarçafët e një personi të infektuar. Duke ditur këtë, rreziku për popullatën e përgjithshme mendohet të jetë relativisht i ulët.

Megjithatë, ky nuk është një shpërthim tipik i lisë së majmunëve dhe ne kemi shumë për të mësuar, por deri më tani, shumica e rasteve të raportuara duket të jenë të lehta.

Këto raste të fundit nuk janë tipike për disa arsye:

- Së pari, të gjitha rastet e fundit, përveç njërit, nuk kanë histori përkatëse udhëtimi në zonat ku lija e majmunëve është endemike, në Afrikën perëndimore ose qendrore.
- Së dyti, shumica e rasteve fillestare të konstatuara zbulohen përmes shërbimeve të shëndetit seksual dhe janë mes meshkujve që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj.
- Së treti, për shkak të natyrës së shpërndarjes gjeografike të rasteve në gjithë Evropën dhe më gjerë. Kjo sugjeron se ekziston një “akullnajë” më i madh i transmetimit i pazbuluar dhe mund të ketë vazhduar për disa kohë.

Veprimi më i rëndësishëm tani është të angazhohemi me njerëzit rreth asaj se çfarë është lija e majmunëve dhe si mund të parandalohet / ndërpritet bartja. Ndërsa, të gjithë mund të infektohen nga virusi i lisë së majmunit, jo të gjithë janë në

rrezik të barabartë. Njerëzit që ndërveprojnë ngushtë me dikë që është infektiv janë në rrezik më të lartë për t'u infektuar: kjo përfshin punonjësit e shëndetësor, anëtarët e familjes, partnerët seksualë dhe punonjësit e seksit.

7. A dëshiron OBSH që festivalet, tubimet masive dhe festat të anulohen këtë verë?

Aspak, por është ajo që bëjnë njerëzit në festa, ajo që ka rëndësi sepse sjelljet e rrezikshme seksuale në këto tubime dhe në përgjithësi mund të përforcojnë dhe zgjasin mëtej përhapjen pasi raste të tilla ofrojnë të rinjë dhe të cilët janë shumë të lëvizshëm.

Ne duam që njerëzit të kënaqen, por duam që ata t'a bëjnë këtë në mënyrë të sigurt. Ne inkurajojmë sjelljen e sigurtë seksuale dhe higjienën e mirë si larja e rregullt e duarve, për të kufizuar përhapjen e virusit.

Është e rëndësishme që njerëzit të informohen për linë e majmunit dhe të dallojnë shenjat dhe simptomat. Çdo person që është i shqetësuar për një skuqje të pazakontë duhet të konsultohet me mjekun ose ofruesin e kujdesit shëndetësor.

8. Çfarë dimë për situatën epidemiologjike në vendet e tjera anembanë Evropës?

Modele të ngjashme transmetimi janë raportuar në të gjithë Evropën.

Rastet e para të konfirmuara janë kryesisht ndër meshkujt e rinj që janë paraqitur në klinikat e shëndetit seksual dhe shumica janë meshkuj që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj.

Disa episode të transmetimit janë raportuar edhe jashtë këtij grupi duke prekur numër të ultë femrash.

Derisa, po hyjmë në verën evropiane, me tubime dhe festivale që bashkojnë shumë të rinj seksualisht aktiv, profili i rasteve mund të zgjerohet.

Ne duhet të kuptojmë se virusi do të përhapet përmes kontaktit të zgjatur dhe të ngushtë, pavarësisht nga kombësia, seksi apo preferencat tona seksuale.

9. A ekziston vakcina kundër lisë së majmunit?

Vaksinat e përdorura gjatë programit të çrrënjësjes së lisë së madhe (variolës) ofron gjithashtu mbrojtje kundër lisë së majmunëve.

Pas çrrënjësjes së lisë së madhe në vitin 1980 dhe ndërprerjes së Programit për Çrrënjësinë në fillim të viteve 1980, dobësimi i imunitetit të popullsisë të shkaktuar nga vakcina rezultoi në mungesën e mbrojtjes midis grupmoshave më të reja mund të ketë kontribuar në rishfaqjen e sëmundjes.

Përderisa është miratuar vakcina për parandalimin e lisë së majmunëve dhe vakcina tradicionale e lisë së madhe është demonstruar se ofron mbrojtje, këto dy vakcina nuk janë gjerësisht të disponueshme. Në varësi të furnizimit, grupet që mund t'u ofrohet vakcina përfshijnë punëtorët shëndetësor të ekspozuar të pambrojtur

OBSH po punon me prodhuesit e vaksinave për të vlerësuar rritjen e kapaciteteve prodhuese nëse kërkohet.

10. Evropa ka krijuar program vaksinimi kundër COVID-19. A duhet ta bëjmë këtë për linë e majmunëve?

Vlen të kujtohet se simptomat e lisë së majmunit mund të jenë të pakëndshme, shumica e njerëzve shërohen brenda pak javësh pa pasur nevojë për ndonjë trajtim apo vaksinë.

Mjetet për të menaxhuar linë e majmunëve në Evropë, duke përfshirë diagnostikimin, vaksinën dhe terapinë nuk ka të ngjarë të jenë menjëherë ose gjerësisht të çasshme për

shtetet.

Përderisa është miratuar vakcina për parandalimin e lisë së majmunëve dhe vakcina tradicionale e lisë së madhe është demonstruar se ofron mbrojtje, këto dy vakcina nuk janë gjerësisht të disponueshme. Në varësi të furnizimit, grupet që mund t'u ofrohet vakcina përfshijnë punëtorët shëndetësor të ekspozuar të pambrojtur

OBSH po punon me prodhuesit e vaksinave për të vlerësuar rritjen e kapaciteteve prodhuese nëse kërkohet.

11. Ka shqetësime se shpërthimi i lisë së majmunëve mund të ketë ndikim në shërbimet e shëndetit seksual?

OBSH-ja është e vetëdijshme për rrezikun për shërbimet rutinë të shëndetit seksual, veçanërisht nëse punonjësit e kujdesit shëndetësor duhet të izoloohen si rezultat i ekspozimit ndaj virusit – veçanërisht nëse nuk kanë ndërmarrë masa mbrojtëse të përshtatshme për parandalimin dhe kontrollin e infeksionit. Prandaj, është shumë e rëndësishme që punonjësit shëndetësor të informohen për sëmundjen, të jenë në gjendje t'a njohin atë dhe të pajisen me Paisje Personale Mbrojtës të nevojshme dhe të trajtohen për përdorimin.

Kohëve të fundit, shumë pacientë janë paraqitur në klinikat e shëndetit seksual, por pacientët mund të shkojnë edhe te mjeku i përgjithshëm ose në klinikat e dermatologjisë, ndaj është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi dhe gatishmëria nga të gjithë.

Mos harroni, ndërsa disa nga rastet janë raportuar në mesin e njerëzve me kontakt të ngushtë dhe seksual, ky virus mund të prekë këdo. Është e gabuar të stigmatizosh dikë.

12. Si mund të kontrollohet epidemia?

Prioriteti i OBSH/Evropës është të përshpejtojë veprimet rajonale, të udhëhequra nga shteti dhe komuniteti pan-evropian

për të kufizuar përhapjen duke çmitizuar linë e majmunëve dhe duke siguruar që askush mos të stigmatizohet në përgjigjen tonë kolektive.

Ne do t'i inkurajojmë njerëzit – përfshirë të rinjtë – pavarësisht gjinisë dhe orientimit seksual, të cilët kanë një skuqje atipike, të kontaktojnë shërbimet mjekësore.

Ka ende shumë për të mësuar rreth kësaj epidemie dhe ne duhet të punojmë së bashku, të përshtasim përgjegjen e shëndetit publik, derisa të kemi më shumë të dhëna.

Kemi mësuar shumë nga përvoja jonë me COVID-19, sa i përket bashkëpunimit ndërmjet shteteve, mbikëqyrjes së shtuar, komunikimit në shëndetin publik, përfshirë edhe komunitetin – të gjitha këto mësimë mund të shfrytëzohen dhe veprimet tona të jenë të orientuara edhe në këtë kohë.

13. Çfarë rekomandon OBSH për të ndaluar përhapjen e lisë së majmunit?

Së pari, është e rëndësishme që njerëzit të informohen për linë e majmunëve dhe të dallojnë shenjat dhe simptomat. Çdo person që është i shqetësuar për një skuqje të pazakontë duhet të konsultohet me mjekun.

Simptomat mund të jenë të lehta ose të rënda, lezionet mund të jenë shumë të kruajtshme ose të dhimbshme. Këto përfshijnë skuqje vezikulare të përhapura ose leziona në çdo pjesë të trupit.

Shumica e rasteve të fundit të paraqitura në klinikat e shëndetit seksual në Evropë kanë qenë me skuqje dhe leziona në organet gjenitale dhe anusin. Skuqja ose lezionet mund të shoqërohen me ethe, dhimbje të fytyrës, ënjtje të nyjeve limfatike dhe leziona të gojës dhe syve. Shumica e njerëzve shërohen brenda pak javësh pa trajtim.

Së dyti, për ofruesit e kujdesit shëndetësor çdo pacient me dyshime për linë e majmunit duhet të hetohet, izolohet gjatë fazës së infektueshmërisë të supozuar dhe të njohur

përkatësisht nga simptomat e para dhe fazat e skuqjes së sëmundjes, përkatësisht.

Higjiena e duarve dhe e frymëmarrjes, së bashku me pajisjet personale mbrojtëse dhe izolimi adekuat i rasteve të dyshimta dhe të konfirmuara janë gjithashtu kritike për të reduktuar transmetimin në mjediset e kujdesit shëndetësor – masat që të gjithë i kemi ndjekur për COVID-19.

Dhe për autoritetet shëndetësore. Fakti që këto raste po zbulohen dhe raportohen tregon se sistemet tona të mbikëqyrjes po funksionojnë dhe ne dëshirojmë të falënderojmë vendet për veprimin e tyre të shpejtë dhe shkëmbimin transparent të informatave. Është thelbësore që bashkëpunimi të vazhdojë, ndërsa situata evoluon mëtej.

Gjurmimi me kohë i kontakteve, masat e mbikëqyrjes dhe komunikimi i rrezikut midis ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe popullatës së gjerë në përgjithësi janë të rëndësishme për parandalimin e rasteve të mëtejshme dhe menaxhimin efektiv të shpërthimit aktual.

Është e rëndësishme që të gjithë të kujtojmë edhe pse virusi nuk përhapet lehtë mes njerëzve, ai mund të prekë këdo dhe personat që preken nga lija e majmunëve nuk duhet të stigmatizohen apo diskriminohen në asnjë mënyrë.

14. Disa shtete këshillojnë që personi i infektuar ose kontaktet e ngushta të tyre të duhet të izolojnë për një periudhë 21-ditore. A jeni dakord me këtë?

OBSH këshillon që pacientët me linë majmuni të konfirmuar ose të mundshëm duhet të izolojnë sa të jetë e mundur deri në largimin e simptomave (përfshirë largimin e çdo skuqje dhe ndërrimin në lëkurë). Në disa raste, kjo mund të zgjasë disa javë.

Gjurmimi i kontaktit është masë kyçe e shëndetit publik për të kontrolluar përhapjen e patogjenëve të sëmundjeve infektive si

virusi i lisë së majmunit.

Kontaktet duhet të monitorohen të paktën çdo ditë për shfaqjen e shenjave/simptomave për një periudhë 21-ditore nga kontakti i fundit me një pacient ose materialet e tij të kontaminuara gjatë periudhës infektive.

Kontakti i afërt i dikujt që është infektuar dhe që nuk paraqet asnjë shenjë apo simptom, duke përfshirë temperaturën, mund të vazhdojë aktivitetet rutinë të përditshme si të shkosh në punë dhe të ndjekë shkollën (nuk është e nevojshme izolimi), por duhet të bëjë kontrolle të temperaturës dy herë në ditë. Masat paraprake shtesë mund të jenë të nevojshme për kontaktet që mund të vijnë në kontakt me individë të cenueshëm ndaj sëmundjeve të rënda (fëmijët e vegjël, individët me imunitet të kompromentuar dhe gratë shtatzëna).